
**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“NABI Sh.p.k.**

**AKT- THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“NABI” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “NABI” Sh.p.k. dhe me emer tregtare “NABI” zoterohet nga ortaku:

1. **Znj. Wendy Qelija, shtetesia shqiptare e lindur me 31/07/1998, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me Nr. J85731102S.**
2. **Znj. Erisa Ferra, shtetesia shqiptare e lindur me 14/10/1993, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me Nr. J36014013K.**

Në përputhje me vullnetin tone te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjislacionit shqiptar, vendosem të hartojmë këtë akt themelimi të shoqërisë “NABI” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me initiale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise “NABI” Sh.p.k.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionojë në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjislacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga Abdi Toptani, Qendra Tregtare Toptani, Kati 1, Njesia D1, Tiranë.

Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik.

Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit në organin kompetent. Shoqëria priset dhe kalon në procedure likuidimi, sipas rasteve të parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqëria “**NABI**” sh.p.k është e organizuar në formën e një shoqërie që merret me:

Shoqëria ka si objekt kryesor të veprimtarisë ofrimin e shërbimeve profesionale në fushën arkitekturës së brendshme, interior design, konceptimin estetik, dekorimin dhe arredimin e hapësirave, përfshirë por pa u kufizuar në hapësira banimi, tregtare, shërbimi, rekreative dhe eventesh.

Në kuadër të veprimtarisë së saj, shoqëria ushtron gjithashtu aktivitet në fushën e organizimit dhe menaxhimit të eventeve familjare dhe shoqërore, si dhe të eventeve të tjera private ose publike, duke përfshirë konceptimin kreativ të eventit, planifikimin, koordinimin logjistik, dekorimin tematik, arredimin e hapësirave ku zhvillohet event, përzgjedhjen dhe vendosjen e elementeve dekorative, mobilie, ndriçimit dhe materialeve ndihmëse.

Shoqëria mund të ofrojë shërbime konsulence, ideimi, vizualizimi, dizajni konceptual dhe ekzekutiv, si dhe shërbime mbështetëse të lidhura drejtpërdrejt ose tërthorazi me fushat e mësipërme, përfshirë bashkëpunimin me subjekte të treta për realizimin e projekteve dhe eventeve.

Shoqëria mund të ushtrojë çdo veprimtari tjetër tregtare, shërbimi ose ndihmëse që lidhet ose i shërben realizimit të objektit të saj, si dhe çdo aktivitet tjetër të lejuar nga legjislacioni shqiptar në fuqi, me qëllim përmbushjen e objektit të veprimtarisë së saj.

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë), i ndarë në 2 (dy) pjesë.
Kapitali themeltar i shoqërisë zoterohet nga:

1. **Znj. Wendy Qelija, shtetesia shqiptare e lindur me 31/07/1998, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me Nr. J85731102S, zoteron 1 (nje) kuote te barabarte me 50 % te vleres se kapitalit te shoqerise ose ne vlere 5,000 Lekë (pese mije leke).**
2. **Znj. Erisa Ferra, shtetesia shqiptare e lindur me 14/10/1993, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me Nr. J36014013K, zoteron 1 (nje) kuote te barabarte me 50 % te vleres se kapitalit te shoqerise ose ne vlere 5,000 Lekë (pese mije leke).**

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne nje llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, pervec këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërise.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të jenë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator edhe pse nuk eshte ortak. Në çdo rast, kur termi “Administrator” përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise “**NABI**” Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijojë edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezigjatja dhe kompetencat e tyre. Administratore te shoqërise jane emeruar:

1. **Znj. Wendy Qelija, shtetesia shqiptare e lindur me 31/07/1998, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit me Nr. J85731102S te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe per nje periudhe 5 vjecare.**
2. **Znj. Erisa Ferra, shtetesia shqiptare e lindur me 14/10/1993, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, e identifikuar nga karta e identitetit**

me Nr. J36014013K te cilit i besohen te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem dhe **per nje periudhe 5 vjecare.**

Shoqëria administrohet nga dy (2) Administratorë, të cilët ushtrojnë funksionet e administrimit dhe përfaqësimit të shoqërisë në mënyrë të pavarur ose së bashku, sipas këtij Statuti.

Secili Administrator ka të drejtë të ushtrojë individualisht, pa kufizime, administrimin e zakonshëm dhe administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë, si dhe ta përfaqësojë shoqërinë përballë të tretëve, autoriteteve publike dhe private, institucioneve financiare dhe bankare, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Veprimet e ndërmarra nga secili Administrator, në ushtrim të kompetencave të mësipërme, janë **plotësisht të vlefshme dhe detyruese për shoqërinë**, pa qenë e nevojshme firma ose miratimi i Administratorit tjetër, përveç rasteve kur ligji ose ky Statut parashikon shprehimisht ndryshe.

NENI 9

DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likuidimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ekzemplare ne gjuhen shqipe duke patur secili ekzemplarë fuqi të njëjtë ligjore.

Tirane, 05/01/2026

ORTAKET E SHOQERISE

Wendy Qelija



Erisa Ferra

